



| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijmjenj/Prodato Received/Delivery | 01.02.2021 | 1 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit | Nr Prct Br Prct Prct No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicana Quantity |
| SKOMBHEK | 415/2021 | | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.422/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.422/2020 të datës 17.12.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. “Sadik Zeneli”, Llamella G 3/2, Nr.3, në Prishtinë, kundër Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.422/2020 e datës 17.12.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me Nr.88/2020 i datës 28.09.2020 i Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 17.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3182/2020 të regjistruar me numër A.nr.422/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos zbatimin e Vendimit Nr.88/2020 të datës 28.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë përmes të cilit është sistemuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Masa dhe Dënime Alternative në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës, si dhe mos kompensimin e pagave nga data 03.06.2020 deri më datë 28.09.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 22.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Drejtësisë. Me datë 30.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Sporvues i Kosovës, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot: 3182/2020 të datës 17.12.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.88/2020 të datës 28.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë; Qarkoren e datës 06.07.2020 të Ministrisë së Drejtësisë; E-mailin e datës 23.10.2020 nga ankuesi për S.S; Vendimin me Nr.14/32 të datës 03.06.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Njoftimin e datës 28.08.2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me pozitat e kategorisë së lartë drejtues; E-mailin e datës 08.05.2020 nga Ministria e Drejtësisë me ankuesin; Vendimin me Nr.4/2012 të datës 09.03.2012 të Ministrit të Drejtësisë dhe Përgjigjen në ankesë të datës 30.12.2020 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.14/32 të datës 03.06.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi me datë 03.06.2015 është emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me mandat pesë (5) vjeçar. Emërimi i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues është bërë sipas dispozitave të nenit 236 të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi, përmes e-mailit të datës 08.05.2020 është njoftuar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë se nuk do ti vazhdohet mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës pas përfundimit të tij me datë 03.06.2020.

Pas përfundimit të mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues, me datë 28.09.2020, përmes Vendimit me Nr.88/2020 të Ministrit të Drejtësisë, ankuesi është sistemuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Masa dhe Dënime Alternative në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Ankuesi me datë 17.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me mos zbatimin e Vendimit me Nr.88/2020 të datës 28.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë përmes të cilit vendim ankuesi është sistemuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Masa dhe Dënime Alternative, si dhe mos kompensimin e pagave nga data 03.06.2020 deri më datë 28.09.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pranushmërisë se ankesës, ka gjetur se vendimi i goditur me ankesë është lëshuar pa informacion lidhur me mjetet juridike, andaj Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është ushtruar në pajtim me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj.*

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për mos zbatimin e Vendimit Nr.88/2020 të datës 28.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe mos kompensimin e pagave nga data 03.06.2020 deri më datë 28.09.2020, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020, përkatësisht nenin 42 paragrafi 7 ku përcaktohet se: *Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni,*



për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale, si dhe paragrafin 8 ku përcaktohet se: Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se kjo norme juridike rregullon çështjen e sistemimit dhe kompensimin e zyrtarëve të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtaret Publik, dhe nuk ka fuqi prapavepruese për nëpunësit civil të cilët kanë përfunduar mandatin në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, siç është rasti i ankuesit. Kolegji po ashtu ka konstatuar se çështja e sistemimit të zyrtarëve të kategorisë së lartë drejtuese me rastin e mbarimit të mandatit është në kompetencë të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, njësi kjo në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike. Andaj, meqenëse ankuesit i ka përfunduar mandati me datë 03.06.2020 para hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtaret Publik, si dhe duke marr parasysh se sistemimi i ankuesit nuk është bërë nga organi kompetent, respektivisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, Kolegji vlerëson se Vendimi Nr.88/2020 i datës 28.09.2020 i Ministrit të Drejtësisë për sistemimin e ankuesit në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Masa dhe Dënime Alternative është nxjerr në kundërshtim me nenin 42 paragrafi 7 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 si dhe nën 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.422/2020

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës;
- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik – MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

